



Prishtinë, 07.10.2020

**Përgjigjet në komentet e pranuar gjatë procesit të konsultimit publik
për
Shqyrtimin e tarifave të energjisë termike – Raporti për të Hyrat e Lejuara për NQ
Termokos – sezoni 2020/2021**

1. Hyrje

Në përputhje me kërkesat ligjore, me datë 21 shtator 2020, ZRRE ka nxjerrë në konsultim publik Draft Raportin: Vlerësimet Preliminare për Përcaktimin e të Hyrave të Lejuara për NQ Termokos për sezonin 2019/2020. Me këtë rast të gjithë palët e involvuara dhe publiku i gjerë janë ftuar për të dhënë komentet e tyre në këtë Raport. Po ashtu në kuadër të procesit të konsultimit publik, ZRRE ka patur takim me NQ Termokos ku janë diskutuar dhe dhënë shpjegime për disa nga komponentët kryesorë të të Hyrave të lejuara. Gjatë konsultimit publik ZRRE ka pranuar komentet me shkrim vetëm nga NQ Termokos.

2. Përgjigjet në komentet e pranuar nga NQ Termokos

Koment 1: Kostoja e lëndës djegëse - mazutit

“Kostoja prej 1000€, , paraqet shpenzimet për lëndë djegëse naftë, të cilën Termokos e përdorë për konzervimin e 5 kaldajave : 3 kaldaja në Termokos dhe 2 kaldaja për Qendrën Spitalore”

Përgjigje

Komenti i NQ Termokos për koston e lëndës djegëse – mazutit ka të bëjë me përfshirjen e koston prej 1,000 € për naftën e cila shërben për konzervimin e kaldajave që janë kapacitet rezervë për prodhimin e energjisë termike në rast të ndonjë ndërprerje të pa-planifikuar të energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B. Për të rikujtuar, NQ Termokos ka paraqitur koston e lëndës djegëse në vlerë prej 320,500 €, për të cilën ka dhënë detaje se bazohet në sasinë e mazutit prej 710 ton me çmimin e blerjes prej 450,000, që është e barabartë me 319,500 €; ndërsa nuk ka specifikuar shtesën prej 1,000 €.

Lidhur me specifikimin e tanishëm (në koment) për shumën shtesë prej 1,000 €, ZRRE thekson se konzervimi i kaldajave i takon mirëmbajtjes, dhe rrjedhimisht kjo kosto i takon koston së mirëmbajtjes. Pra më konkretisht, në këtë rast nafta nuk përdoret si lëndë djegëse për prodhimin e energjisë termike por për konzervim të pajisjes makinerike, kështu që kostoja shtesë prej 1,000 € nuk përfshihet në koston e lëndës djegëse.



Koment 2: Kostoja / pagesa e taksës vjetore të licencimit

“Taksën vjetore të licencimit për prodhim të ngrohjes nga mazuti, e kemi paraqitur në “Shpalosjen e Pasqyrës Rregullative B” në vlerë prej 1,364 €, të përbashkët me koston e taksës vjetore të licencimit për prodhimin nga kogjenerimi në vlerë prej 26,764.80€, që në total jep vlerën 28,128.80€.”

Përgjigje:

Gjatë analizimit të dhënave të paraqitura nga NQ Termokos, është vërejtur se kjo kosto është kategorizuar nën pozicionin ‘Kostot e shitjes dhe tjera administrative’ (shih fq.14 të Raportit). Siç është theksuar në raport për komponentën e taksës së licencimit alokimi i drejtë është si vijon: pagesa e taksës së licencimit për energjinë termike nga kogjenerimi është llogaritur në komponentën variabile të kostonë së energjisë termike nga kogjenerimi (shiko fq.9), si dhe po ashtu taksa vjetore e licencimit për prodhimin e energjisë termike në stabilimentet e ngrohtores është alokuar nën ‘kostot variabile’ (shiko fq.10).

Koment 3: Investimet e reja me vetë-financim – Ndërtimi i objektit të NQ Termokos

Lidhur me investimet e reja me vetë-financim, konkretisht për ndërtimin e objektit të zyrës qendrore dhe administrative të NQ Termokos ka dërguar disa komente si në vijim:

- *“Arsyeja që vlera e tanishme e këtij investimi është 1,350,000.00 €, siç ju kemi informuar në dokumentacionin e dërguar për shqyrtim tarifor 2020/2021, qëndron në faktin se në kuadër të kësaj vlere, përveç ndërtimit të objektit dhe mbikqyrjes janë paraparë edhe shërbimet tjera për:*
 - *ç ’vendosjen e nënstacionit për pranimin e mazutit,*
 - *rrënimin e objektit (punëtoria e axhustatorëve),*
 - *largimin (eliminimi) e dy rezervuarëve të mazutit.”*
- *“Procedurat e realizimit/ sigurimit të dokumentacioneve të nevojshme lidhur me këtë investim, kanë marrë shumë kohë, gjë që ka ndikuar në realizimin e vetëm 67,980€ apo (12.83%) të vlerës së lejuar nga ZRRE prej 530,000euro në shqyrtimin tarifor të sezonit të kaluar 2019/2020.”*
- *“Është fakt që ndryshimi i vlerës së këtij investimi, duhet të përfshihet në azhurnimin e Planit Zhvillimor 2019/2029, që nënkupton edhe aprovimin e ZRRE-së. Mirëpo, meqenëse çështja e dy projekteve kryesore të përfshira në këtë dokument, ende nuk është definuar përfundimisht, nuk kemi mundur të bëjmë azhurnimin e Planit Zhvillimor 2019/29 para periudhës së dërgimit të dokumentacionit për shqyrtim tarifor 2020/2021.
Kjo ka të bëjë me projektin e Komisionit Europian “Projekti për rehabilitim dhe zgjerim të rrjetit”, i cili do të përfundojë gjatë muajit tetor 2020, prandaj nuk kemi ende raport përfundimtar për realizimin e këtij projekti, si dhe Projekti i KFW “Projekti për rehabilitim dhe zgjerim të rrjetit”, për të cilin ende nuk e kemi pranuar specifikimin e segmenteve- komponenteve të cilat do të realizohen.”*
- *“Duke marrë për bazë faktet e lartëcekura, ju lutemi ta rishikoni vlerën e lejuar lidhur me këtë investim.”*



Përgjigje:

Ashtu siç është përshkruar edhe në Raportin për konsultim publik, ZRRE ka dhënë vlerësimet përkatëse të cilat, ndërlidhur me komentet e lartë-përshkruara, përmbledhen si në vijim:

- Me hartimin e projektit detal ka ndërruar koncepti i ndërtimit të objektit duke rritur dukshëm përmasat e objektit dhe etazhitetin, që ka përfshirë edhe punime shtesë dhe kjo natyrisht ka rezultuar me një vlerë dukshëm më të madhe se vlera fillestare e paraparë e investimit për këtë projekt. Gjithashtu duhet përmendur se projekti i ndërtimit të objektit administrativ është përfshirë në Planin zhvillimorë afatgjatë në vlerë prej 530,000 €.
Lidhur me këtë, ZRRE dëshiron të theksoj se çdo ndryshim i projekteve investive duhet të reflektohet në azhurnimin e Planit Zhvillimor që nënkupton edhe aprovimin e ZRRE-së, gjë që nuk është bërë nga NQ Termokos. Për më tepër ndryshimet përkatëse të investimeve paraprakisht të aprovuara duhet të jenë mirë të arsyetuara dhe të argumentuara.
- Në sezonin e kaluar për ndërtimin e objektit është paraqitur shuma prej 530,000 €, e cila vlerë po ashtu është edhe në Planin Zhvillimorë afatgjatë. Konkretisht në shqyrtimin e kaluar për sezonin 2019/2020, ZRRE ka pranuar investimin në ndërtimin e objektit në shumën 530,000, prej së cilës shumë janë realizuar vetëm 67,980 € (12.83%) për hartimin e Studimit të Fizibilitetit: Vlerësim i situacionit dhe objekteve të NP "Termokos" sh.a dhe hartimin e projektit detal ndërtimor.
- Arsyetimi i lartëcekur për pamundësinë e azhurnimit të Planit Zhvillimor afatgjatë dhe dorëzimit për aprovim në ZRRE, për shkak të dy projekteve tjera investive (të Komisionit Evropian dhe KfW), është i pabazuar.

Bazuar në përgjigjet më lartë, ZRRE qëndron pranë vlerësimeve të veta për vlerën e lejuar të investimit. Konkretisht shumën e lejuar në shqyrtimin e kaluar prej 530,000 € e bartë në shqyrtimin aktual tarifor për sezonin 2020/2021 duke hequr vlerën prej 67,980 € të realizuar në sezonin e kaluar, si dhe shton vlerën e pjesëshme për mbikqyrje të ndërtimit 20,000 €. Kjo rezulton me vlerën prej **482,000 €** e cila lejohet për periudhën njëvjeçare të shqyrtimit tarifor si investim për ndërtimin e objektit të ri administrativ.

Përgatitur nga DETG, ZRRE